

**Thirrje për aplikim
Për Konsulentë / Trajnerë**

ToKeQark SB NI KOS 09/2023

Publikuar me: 1 nëntor 2023

Afati i hapur për aplikim: 15 nëntor, 2023

1. Hyrje

The Balkan Forum kërkon të rekrutojë katër [4] konsulentë / trajnerë, të cilet do të dizajnojnë dhe zbatojnë trajnime në kuadër të projektit ToKeQark si përshkruhen në vijim:

Projekti "ToKeQark" SB NI KOS 09/2023 ka si qëllim parësor promovimin e qëndrueshmërsisë mjedisore dhe zbutjen e ndryshimeve klimatike duke i trajtuar sfidat mjedisore përmes përfshirjes së komunitetit/palëve në diskutim, si dhe të ofrojë informata të përditësuara lidhur me tranzicionin drejt ekonomisë qarkore në Kosovë e në veçanti, në katër komuna të Kosovës: Ferizaj, Fushë Kosovë, Graçanicë dhe Mitrovicë. Projekti financohet nga SMART BALKANS, i mbështetur financiarisht nga Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë (NMFA) dhe zbatohet nga The Balkan Forum.

2. Objektivat e trajnimit:

Konsulentët / Trajneret do të zhvillojnë një program trajnimi [sipas pikes 3 dhe 4] me metoda interaktive që ngrisin njohuritë dhe kapacitetet për 60 të rinj dhe studentë dhe për t'u mundësuar atyre që të jenë krijues të zgjidhjeve inovative për vetëdijësimin e komunitetit lidhur me benifitet potenciale që mund të vijnë nga tranzicioni / kalimi nga ekonomia lineare në ekonomi qarkore, si dhe zbatimin e një nisme rinore në komunitetin e tyre.

3. Zhvillimi i Programit të Trajnimit 3 ditor:

Temat që do të trajtohen në trajnimin 3 ditor do të përfshijnë (por pa u kufizuar në):

- Hyrje në sfidat mjedisore dhe pasojat e ndryshimeve klimatike dhe humbjes së biodiversitetit në botë, rajon, Kosovë dhe komunat ku po zbatohet trajnimi
- Ndryshimet klimatike që ndërlidhen me paqen dhe sigurinë.
- Hyrje në ekonominë qarkore [EQ]: çfarë është, cilat janë parimet kryesore të saj, cili është kontributi i EQ në ndryshimin e klimës dhe mbrojtjen e mjedisit, si përfitojnë qytetarët, bizneset, qeveritë.
- Zgjidhje të suksesshme inovative të EQ ndaj sfidave të lidhura me klimën dhe mjedisin në botë, rajon dhe Kosovë (përfshirë mjetet dhe metodologjinë e përdorur nga UNEP dhe të përshtatura me kontekstin e Kosovës).
- Trajnimi do të zbatohet duke përdorur metoda interaktive, të qasshme, për të promovuar bashkëpunimin dhe ndjenjën e asociimit të pjesëmarrësve
- Trajnimi do duhej të nxisë pjesëmarrjen dhe angazhimin e të rinjve përmes aktiviteteve, diskutimeve dhe punës në grup.

4. Zhvillimi i Seminarit njëditor në temë "Zgjidhjet inovative për Ekonomi Qarkore"

Gjatë këtij seminary njëditor, pjesëmarrësit e rinj do të bashkëpunojnë me një mentor në grupe të vogla për të filluar zhvillimin e idesë së tyre në një koncept projekt. Seminari do të mbulojë bazat e menaxhimit dhe zbatimit të projektit, si dhe do të eksplorojë zgjidhje novatore të ekonomisë qarkore që mund të jenë relevante dhe të suksesshme në komunat e tyre. Mentorët do t'u ofrojnë pjesëmarrësve shabllonet e përmendura më lart dhe do t'i udhëzojnë se si t'i plotësojnë ato në mënyrë efektive. Më e rëndësishmja, ky seminar do t'i inkurajojë pjesëmarrësit t'i bëjnë vetes pyetje përkatëse në lidhje me idetë e tyre të projektit dhe të mendojnë mënyrat për të arritur ndikim të rëndësishëm me burime të kufizuara financiare.

5. Periudha e shërbimit

Trajnimet planifikohen të organizohen në periudhën dhjetor 2023 dhe janar-shkurt 2024 në Prishtinë.

Aktiviteti / Shërbimi	Periudha
Trajnim 3 ditor per 60 pjesëmarrës [4 dite pune/trajner]	dhjetor 10-20, 2023
Semiar 1 ditor per 60 pjesëmarrës [2 dite pune per trajner]	janar-shkurt 2024

6. Të intersuarit duhet të dorëzojnë

Të interesuarit duhet të demonstrojnë se kanë përvojë në ofrim të shërbimeve duke dorëzuar dokumentet në vijim:

- CV ku theksohet përvoja në trajnime dhe në teme relevante për këtë thirrje.
- Koncept-Planin e trajnimit [outline] ku përshkruhet metodologjia, synimet, paisjet, formati [max. 1 faqe]
- Listë të trajnimeve të dizajnuara dhe të lehtësuara/mbajtura nga trajneri në 5 vitet e fundit.

Procedura e aplikimit

Oferta dërgohet në email adresën dren@thebalkanforum.org & info@thebalkanforum.org . Aplikimet që nuk përbajnë dokumentet e kërkuara nuk do të konsiderohen për vlerësim.

Afati për aplikim është i hapur deri me datë 15 nëntor 2023.

Vetem aplikimet që hyn në listë të ngushtë do të kontaktohen nga ekipi i The Balkan Forum